

VENDIM
Nr. 8, datë 11.1.2024

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E
STATUSIT TË KLIENTIT NË NEVOJË NË FURNIZIMIN ME GAZ NATYROR
DHE MËNYRËN E TRAJTIMIT TË TYRE**

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 97, të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky vendim përcakton kriteret dhe procedurat për kualifikimin e klientëve në nevojë të gazit natyror dhe përcakton specifikat e furnizimit me gaz natyror për këta klientë, si dhe mbështetjen financiare (ndihmën shoqërore) dhe masa të tjera mbrojtëse përkatëse.

Neni 2

Mbrojtja e klientëve në nevojë të gazit natyror, si një instrument me qëllim të veçantë i mbështetjes financiare (ndihmës shoqërore) dhe përfitimeve të tjera të përfituara nga një individ në kuadrin e skemës së mbrojtjes sociale të Republikës së Shqipërisë, nuk e parashikon të drejtën për përfitim si një klient në nevojë i gazit natyror, nëse nuk përcaktohet shprehimisht në këtë vendim.

Neni 3

Ky vendim është detyrues për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror dhe zbatohet me përpikëri nga të gjitha organet publike gjatë vendimmarrjes së tyre legjislative, administrative apo rregullatore në kuadrin e kompetencave të tyre, përfshirë masat për mbrojtjen e klientit dhe ofrimin e shërbimeve me standarde të larta në sektorin e gazit natyror.

KREU II
KRITERET PËR KUALIFIKIM SI KLIENT NË NEVOJË

Neni 4

1. Çdo klient familjar me adresë të përhershme në Republikën e Shqipërisë ka të drejtën të aplikojë për statusin e klientit në nevojë të gazit natyror nëse bën pjesë në kategoritë përfituese, si më poshtë vijon:

- a) familjet përfituese të ndihmës ekonomike dhe të fondit 6% (gjashtë për qind), sipas ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- b) familjet që kanë anëtarë “persona me aftësi të kufizuar” (PAK), sipas ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- c) pensionistët dhe invalidët e punës, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- ç) të verbrit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;

d) Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.

2. Në rastet kur klienti është përfitues në më shumë se një prej kategorive, përfiton sipas rregullave të parashikuara në këtë vendim vetëm si një prej këtyre kategorive.

3. Klientët familjarë e përfitojnë statusin e klientit në nevojë të gazit natyror, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim dhe nëse përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) gazi natyror përdoret si burim kryesor për furnizimin e përhershëm të banesës për ngrohjen apo përgatitjen e ushqimit në banesën ku jeton familja në fjalë;

b) pajisjet e gazit natyror të klientit familjar lidhen me sistemin e shpërndarjes së gazit natyror përmes pajisjeve matëse të instaluar, në përputhje me dispozitat e akteve ligjore në fuqi;

c) klienti familjar është pronar, ka vendbanim ose vendqëndrim në mënyra të tjera ligjore në ambientet e banimit ku jeton familja përkatëse;

ç) një familje e caktuar konsiderohet si familje me të ardhura të ulëta, nëse:

i. të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 70% (shtatëdhjetë për qind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes, ku një familje e veçantë përbëhet nga më pak se 3 (tre) pjesëtarë;

ii. të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 80% (tetëdhjetë për qind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes, ku një familje e veçantë përbëhet nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) pjesëtarë;

iii. të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 90% (nëntëdhjetë për qind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes, ku një familje e veçantë përbëhet nga 6 (gjashtë) ose më shumë pjesëtarë;

iv. të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 100% (njëqind për qind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes, me të paktën 1 (një) individ të moshuar 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç e lart ose të paktën 2 (dy) të mitur deri në moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

v. të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 110% (njëqind e dhjetë për qind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes me 3 (tre) ose më shumë të mitur deri në moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

vi. të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 120% (njëqind e njëzet për qind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes me një individ të diagnostikuar me një aftësi të kufizuar fizike apo mendore, që shkakton humbje të aftësisë në punë, në masën më pak se 60% (gjashtëdhjetë për qind), ose kur një familje e caktuar përbëhet nga një individ i vetëm i moshuar 65 (gjashtëdhjetë pesë) vjeç e lart; ose

vii. të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 150% (njëqind e pesëdhjetë për qind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes, ku një familje e caktuar përfshin të paktën 2 (dy) nga kushtet e përcaktuara më lart.

d) Një familje e caktuar nuk konsiderohet si familje me të ardhura të ulëta sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike, kur niveli i të ardhurave për secilin pjesëtar të familjes nuk është më i lartë se 50% (pesëdhjetë për qind) e vlerës së të ardhurave mujore të përgjithshme faktike (neto), sipas përcaktimeve të sipërpërmendura.

4. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, konsiderohen si shteruese dhe nuk mund të përcaktohen kriteret shtesë që do të ndalonin kualifikimin e klientit familjar, si klient në nevojë të gazit natyror.

KREU III

PROCEDURA PËR KUALIFIKIMIN E KLIENTËVE NË NEVOJË

Neni 5

1. Të gjithë klientët familjarë, që përmbushin kriteret e kualifikimit të përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, të këtij vendimi, kanë të drejtën të aplikojnë nëpërmjet portalit “e-Albania” në njësine

administrative vendore që mbulon territorin ku klienti ka vendbanimin ose vendqëndrimin për marrjen e statusit të klientit në nevojë të gazit natyror.

2. Kërkesa për statusin e klientit në nevojë të gazit natyror realizohet nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, duke bashkëlidhur dokumentacionin që vërteton përmbushjen nga ana e klientit familjar të kriterëve të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, të këtij vendimi.

3. Lista shteruese e dokumentacionit për kategoritë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe të fondit 6 % (gjashtë për qind), si dhe për familjet që kanë anëtarë “persona me aftësi të kufizuar” (PAK), sipas ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, do të jenë:

- a) vërtetimi i Komisionit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar për personat me aftësi të kufizuar;
- b) vërtetimi i lëshuar nga bashkia për kategoritë e ndihmës ekonomike.

4. Dokumentacioni shterues për kategoritë e familjeve përfituese pensionistë dhe invalidë të punës, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të jetë vërtetimi nga drejtoritë rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore ku ndodhet familja përfituese.

5. Dokumentacioni shterues për kategoritë për kategoritë e të verbërve, që përfitojnë ndihmë sipas dispozitave të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit.”, të ndryshuar, do të jetë vërtetimi i Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) ose libreza për statusin e të verbrit, e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

6. Njësia administrative vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e dorëzuar nga një klient familjar, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune pas marrjes së kërkesës dhe:

- a) konfirmon statusin e klientit në nevojë të gazit natyror, nëse klienti familjar përmbush kriteret e kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, të këtij vendimi;
- b) refuzon kërkesën, nëse klienti familjar nuk përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, të këtij vendimi; ose
- c) kërkon plotësimin e dokumentacionit nga klienti familjar, nëse kërkesa nuk është plotësuar sipas kërkesave ose nëse nuk dorëzohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar, sikurse përcaktohet në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij neni, klienti në nevojë që brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të plotësojë dokumentacionin e munguar.

7. Pa paragjykim, në lidhje me pikën 6, të këtij neni, statusi i klientit në nevojë të gazit natyror konfirmohet ose kërkesa refuzohet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune pas plotësimit të kërkesës pranë institucioneve përkatëse vendore, sipas kërkesave dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm të përcaktuar në këtë vendim.

8. Statusi i klientëve në nevojë të gazit natyror konfirmohet kur të gjitha konfirmimet përmbajnë, ndër të tjera, informacion në lidhje me trajtimin e veçantë që gëzon klienti familjar, si rrjedhojë e statusit të tij/saj si klient në nevojë të gazit natyror, sipas kushteve dhe termave të këtij vendimi.

9. Kur kërkesa për statusin e klientit në nevojë refuzohet, refuzimit duhet të justifikohet dhe klientit familjar t’i jepet shpjegim me shkrim, si dhe nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.

10. Një klient familjar, të cilit i është dhënë statusi i klientit në nevojë të gazit natyror me konfirmim, kryen kërkesën pranë operatorit të sistemit të shpërndarjes që i shërben zonës përkatëse të shërbimit të shpërndarjes për përfshirjen e tij/saj në regjistrin e klientëve në nevojë nga pikëpamja shoqërore (në vijim regjistri).

11. Regjistri hapet dhe mirëmbahet nga operatori i sistemit të shpërndarjes, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe përmban të paktën të dhënat e mëposhtme për secilin klient në nevojë të gazit natyror:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) numrin personal të identifikimit;
- c) adresën e banesës së një familjeje të veçantë të furnizuar me gaz natyror;
- ç) numrin rendor, në të cilin është regjistruar në regjistër klienti në nevojë të gazit natyror;
- d) trajtimin e veçantë për shkak të statusit të klientit në nevojë të gazit natyror.

12. Regjistri ruhet në format elektronik dhe aksesit në të është i kufizuar, i autorizuar nga operatori i sistemit të shpërndarjes dhe bazohet në llogari individuale hyrjeje të lëshuara për:

a) furnitorin me detyrime të shërbimit publik – për akses në të dhënat e klientëve në nevojë që banojnë në zonën e shërbyer prej tij; dhe

b) klientin në nevojë të gazit natyror – për akses në të dhënat e veta.

13. Operatori i sistemit të shpërndarjes regjistron një klient familjar në regjistrë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune pas marrjes së kërkesës të tij/saj. Operatori i sistemit të shpërndarjes nuk ka të drejtë të refuzojë regjistrimin e klientit familjar në regjistrë, nëse ky klient gëzon statusin e klientit në nevojë të gazit natyror, të konfirmuar nga zyra e njësisë administrative vendore, ku kërkuesi ka vendbanim ose vendqëndrim.

14. Operatori i sistemit të shpërndarjes, jo më vonë se dita vijuese nga regjistrimi i klientit familjar në regjistrë, njofton me shkrim:

a) furnitorin që ka detyrimin e shërbimit publik, që i shërben një zone të caktuar të shërbimit të shpërndarjes dhe ofron të dhënat e klientit në nevojë të gazit natyror të regjistruara në regjistrë; dhe

b) klientin në nevojë të gazit natyror dhe i ofron atij/asaj informacionin e kontaktit të furnitorit që ka detyrimin e shërbimit publik, që shërben një zonë të caktuar të shërbimit të shpërndarjes së gazit natyror.

KREU IV FURNIZIMI ME GAZ NATYROR PËR KLIENTIN NË NEVOJË

Neni 6

1. Furnitori që ka detyrimin e shërbimit publik, pas marrjes së njoftimit nga operatori i sistemit të shpërndarjes, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas regjistrimit të klientit në nevojë të gazit natyror në regjistrë:

a) nënshkruan një kontratë të re furnizimi me klientin në nevojë të gazit natyror, nëse furnitori dhe klienti në nevojë të gazit natyror nuk kanë një kontratë të vlefshme furnizimi; ose

b) njofton klientin në nevojë të gazit natyror në lidhje me kërkesën për t'u pajisur me statusin e klientit në nevojë të gazit natyror, bazuar në kontratën ekzistuese të furnizimit dhe, kur është e nevojshme, vë në zbatim ndryshimet përkatëse në këtë kontratë.

2. Një kontratë e re furnizimi, siç përcaktohet në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, hyn në fuqi jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas nënshkrimit, nëse palët në kontratë nuk bien dakord për një afat tjetër.

3. Statusi i një klienti në nevojë, sipas shkronjës “a” të pikës 1, të këtij neni, fillon të aplikohet jo më vonë se ditën vijuese pas njoftimit përkatës nga furnitori ose, kur është e nevojshme, jo më vonë se 3 (tre) ditë pune pas hartimit të ndryshimeve në kontratën e furnizimit, përveçse të dyja palët në kontratë bien dakord për një afat tjetër.

4. Kontrata e furnizimit hartohet bazuar në një kontratë tip të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (në vijim ERE).

5. Tarifat për furnizimin me gaz natyror të klientit në nevojë të gazit natyror aplikohen sipas përcaktimeve të ERE-s, bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

6. Për sa nuk rregullohet nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe nga ky vendim klienti në nevojë të gazit natyror furnizohet me gaz sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në kushtet e përgjithshme për furnizimin me gaz natyror dhe rregullat e operimit për furnitorët që kanë detyrimin e shërbimit publik, sipas miratimit të ERE-s dhe kontratës së furnizimit.

KREU V MBËSHTETJA FINANCIARE

Neni 7

1. Të gjithë klientët në nevojë të gazit natyror kanë të drejtën e mbështetjes financiare (ndihmës shoqërore), bazuar në trajtimin e veçantë si rrjedhojë e statusit të tij/saj si klientë në nevojë i gazit natyror, siç përcaktohet në këtë krye.

2. Klientët në nevojë të gazit natyror kompensohen për konsumin e gazit natyror të ofruar dhe furnizuar në banesat e tyre, në masën:

a) 100% (njëqind për qind) të kostove të konsumit të gazit natyror kur klienti në nevojë i gazit natyror kualifikohet sipas shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi;

b) 90% (nëntëdhjetë për qind) të kostove të konsumit të gazit natyror kur klienti në nevojë i gazit natyror kualifikohet sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi, dhe niveli i të ardhurave për secilin pjesëtar të familjes nuk është më i lartë se 10% (dhjetë për qind) të vlerës së të ardhurave të përgjithshme faktike (neto) për muaj, sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi;

c) 80% (tetëdhjetë për qind) të kostove të konsumit të gazit natyror kur klienti në nevojë i gazit natyror kualifikohet sipas shkronjës “ç”, të pikës 3, nenit 4, të këtij vendimi, dhe niveli i të ardhurave për secilin pjesëtar të familjes nuk është më i lartë se 20% (njëzet për qind) të vlerës së të ardhurave të përgjithshme faktike (neto) për muaj, sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi;

ç) 70% (shtatëdhjetë për qind) të kostove të konsumit të gazit natyror kur klienti në nevojë i gazit natyror kualifikohet sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi, dhe niveli i të ardhurave për secilin pjesëtar të familjes nuk është më i lartë se 30% (tridhjetë për qind) të vlerës së të ardhurave të përgjithshme faktike (neto) për muaj, sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi;

d) 60% (gjashtëdhjetë për qind) të kostove të konsumit të gazit natyror kur klienti në nevojë i gazit natyror kualifikohet sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi, dhe niveli i të ardhurave për secilin pjesëtar të familjes nuk është më i lartë se 40% (dyzet për qind) të vlerës së të ardhurave të përgjithshme faktike (neto) për muaj, sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi; ose

dh) 50% (pesëdhjetë për qind) të kostove të konsumit të gazit natyror kur klienti në nevojë i gazit natyror kualifikohet sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi, dhe niveli i të ardhurave për secilin pjesëtar të familjes nuk është më i lartë se 50% (pesëdhjetë për qind) të vlerës së të ardhurave të përgjithshme faktike (neto) për muaj, sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 4, të këtij vendimi.

3. Kostot e konsumit të gazit natyror, referuar në pikën 2, të nenit 7, të këtij vendimi, kanë kuptimin e çmimit të përgjithshëm të paguar për gazin natyror nga klienti në nevojë i gazit natyror, përfshirë çmimin e shpërndarjes dhe furnizimit.

4. Kompensimi për konsumin e gazit natyror, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 7, të këtij vendimi, aplikohen vetëm në përmbushje të kushteve, si më poshtë vijon:

a) Gazi natyror konsumohet në banesën e një familjeje të caktuar, sipas përcaktimeve në këtë vendim;

b) Gazi natyror konsumohet gjatë periudhës së ftohtë për ngrohje, pra nga 1 nëntori në 31 mars, përveç rasteve kur periudha e ftohtë fillon më shpejt dhe zgjat më shumë si pasojë e kushteve ekstreme të motit, sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi;

c) Konsumi maksimal i gazit për familje përllogaritet mbi bazën e periudhave sezonale dhe konsumit mesatar deri në $30 \text{ m}^3/\text{muaj}$ për një familje deri në 4 (katër) anëtarë.

5. Konsumi i gazit natyror nga një klient në nevojë i gazit natyror, që nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, dhe tejkalon volumet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 4, të këtij neni, do të tarifohet plotësisht, bazuar në tarifat e shpërndarjes të gazit natyror të vendosur nga ERE, sipas kushteve dhe termave të përcaktuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe tarifat e furnizimit sipas pikës 5, të nenit 6, të këtij vendimi.

6. Kompensimet ekzekutohen nëpërmjet njësive administrative nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimit të këtij vendimi. Çmimi i aplikuar ndaj kostove të konsumit të gazit natyror të një klienti në nevojë të gazit natyror për çdo muaj përcaktohet qartë në faturat mujore të lëshuara nga operatori i sistemit të shpërndarjes ose furnitori që ka detyrimin e shërbimit publik përkatësisht. Për qëllimet e këtij vendimi, klientët në nevojë të gazit natyror kanë të drejtë për përfitim të drejtpërdrejtë fondesh nga buxheti i shtetit për kryerjen e pagesave ndaj operatorëve të gazit natyror për gazin e konsumuar në banesat e tyre.

7. Fondet përpunohen sipas kushteve dhe termave të përcaktuar nga një udhëzim i përbashkët i ministrit përgjegjës për energjinë, si dhe të ministrit përgjegjës për financat dhe i nënshtrohen procedurës së rimbursimit nga buxheti i shtetit për klientët në nevojë.

KREU VI MASA TË TJERA MBROJTËSE ZBATUAR PËR KLIENTIN NË NEVOJË

Neni 8

1. Shpërndarja dhe furnizimi me gaz natyror për klientët në nevojë të gazit natyror mund të pezullohet apo të ndërpritet sipas termave dhe kushteve të miratuara nga ERE, në përputhje me ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

2. Pavarësisht pikës 1, të këtij neni, shpërndarja dhe furnizimi me gaz natyror për klientët në nevojë të gazit natyror nuk mund të pezullohet apo të ndërpritet në rastet e mëposhtme:

a) Kur një klient në nevojë i gazit natyror nuk paguan plotësisht ose pjesërisht për shpërndarjen ose furnizimin me gaz natyror sipas kërkesave të kontratës përkatëse dhe për sa kohë që borxhi i tij/saj ndaj operatorit të sistemit të shpërndarjes ose furnitorit që ka detyrimin e shërbimit publik nuk kalon 1 (një) nivel minimal të ardhurash; ose

b) Gjatë fundjavës dhe gjatë ditëve të festave zyrtare, si dhe në raste të kushteve kritike të motit, kur temperatura mesatare ditore është më e ulët se -10 (minus dhjetë) gradë celsius.

3. Shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, nuk zbatohen në rastet kur shpërndarja dhe furnizimi me gaz natyror i një klienti në nevojë të gazit natyror pezullohet ose ndërpritet për shkak të masave të sigurisë për sigurimin e furnizimit të detyrueshëm, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

4. Klienti në nevojë i gazit natyror informohet në lidhje me pezullimet apo ndërprerjen e shpërndarjes ose furnizimit me gaz natyror, sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi.

KREU VII MONITORIMI I STATUSIT TË KLIENTIT NË NEVOJË

Neni 9

1. Një klient në nevojë i gazit natyror gëzon këtë status deri në momentin që statusi shfuqizohet me vendim të njësive administrative vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

2. Çdo njësi administrative vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin, monitoron statusin e klientëve të saj në nevojë të gazit natyror, të konfirmuar të paktën 2 (dy) herë në muaj dhe shqyrton përputhshmërinë e tyre me kriteret e kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, nenit 4, të këtij vendimi. Për këtë qëllim, njësia administrative vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin, ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm që sigurohet nga organe të tjera publike kompetente, subjekte private ose klientët në nevojë të gazit natyror. Monitorimi kryhet sipas termave dhe kushteve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse që mbulon fushën e njësive administrative vendore për çështjet sociale.

3. Në rast se njësia administrative vendore, ku kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin, evidenton se një klient në nevojë i gazit natyror nuk është më në përputhje me kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, të këtij vendimi, ajo shfuqizon statusin e klientit në nevojë të gazit natyror dhe informon sa më shpejt, por asnjëherë më vonë se ditën vijuese të

punës pas marrjes së vendimit të shfuqizimit, klientin dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes. Çdo vendim shfuqizimi duhet të arsyetohet dhe të jepet së bashku me shpjegimin me shkrim, sipas rregullave dhe parimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

4. Operatori i sistemit të shpërndarjes, jo më vonë se 8 (tetë) ditë pas marrjes së vendimit të shfuqizimit, referuar në pikën 3, të këtij neni, çregjistron klientin familjar përkatës nga regjistri dhe njofton me shkrim në lidhje me këtë subjekt që çregjistrohet ose furnitorin që ka detyrimin e shërbimit publik.

5. Dita e çregjistrimit të një klienti familjar nga regjistri konsiderohet si dita e fundit e gëzimit të statusit të klientit në nevojë të gazit natyror për këtë konsumator.

6. Referuar pikës 5, të këtij neni, kontrata e furnizimit me një klient në nevojë të gazit natyror përfundon menjëherë pas ditës së çregjistrimit të tij/saj nga regjistri. Me përfundimin e kontratës së furnizimit subjekti i çregjistruar nuk mund të vijojë të gëzojë mbështetjen financiare (ndihmën shoqërore), sipas këtij vendimi.

7. Pas përfundimit të kontratës së furnizimit, siç përcaktohet në pikën 6, të këtij neni, ky klient furnizohet me gaz natyror sipas termave dhe kushteve të furnizimit për klientin familjar, të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror, miratuar nga ERE dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

8. Çdo klient familjar, statusi i klientit në nevojë të gazit natyror i të cilit është shfuqizuar më parë, ka të drejtën e pakufizuar për të aplikuar përsëri për këtë status, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim, bazuar në përputhshmërinë e tij/saj me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, të këtij vendimi.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

1. Të gjithë klientët familjarë kanë mundësinë të informohen nga njësitë administrative vendore ku kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin, operatorët e sistemit të shpërndarjes ose furnitorët që kanë detyrimin e shërbimit publik, brenda fushës së kompetencave të tyre, të gjithë informacionin e lidhur me mbrojtjen e klientëve në nevojë të gazit natyror, përfshirë të gjitha kriteret, procedurat dhe masat e zbatueshme në këtë kuadër.

2. Zbatimi i këtij vendimi monitorohet dhe mbikëqyret nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në një udhëzim të përbashkët të këtyre ministrave.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton sekretariatit e komunitetit të energjisë për praktikën e zbatimit të këtij vendimi, përfshirë kërkesën e mbështetjes financiare (ndihmës shoqërore) dhe masat e tjera mbrojtëse ose ndryshimet përkatëse. Ky njoftim bëhet të paktën 1 (një) herë në vit.

4. Ankesat dhe mosmarrëveshjet, që lindin si pasojë e këtij vendimi, për sa ka të bëjë me cilësinë dhe sasinë e furnizimit me gaz natyror të klientit në nevojë apo me formën dhe sasinë e kompensimit që duhet të përfitojë klienti në nevojë, trajtohen dhe zgjidhen nga:

a) organizmi/Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit - në marrëdhëniet midis klientëve familjarë dhe organeve publike, përfshirë ministrinë përgjegjëse për sektorin e energjisë, si dhe njësitë administrative vendore ku kërkuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin;

b) marrëdhëniet midis klientëve familjarë dhe shoqërive të energjisë ose midis vetë sipërmarrjeve të energjisë, përfshirë operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe furnitorët që kanë detyrimin e shërbimit publik.

5. Individët që kryejnë shkelje të këtyre kushteve të përgjithshme janë përgjegjës sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ose akteve të tjera ligjore në fuqi.

6. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë administrative vendore, si dhe institucionet e

autoritetet e tjera shtetërore përkatëse ngarkohen me hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore, programeve, procedurave, formularëve standardë apo masave të tjera të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas miratimit të tij.

7. Ky vendim do t'i shtrijë efektet në momentin e operimit të infrastrukturës së gazit natyror, i cili përmbush kriteret sipas akteve ligjore në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 11

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama